REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Byroja

V E N D I M

Nr.11, datë 4.3.2011

PËR DHËNJEN E MASËS DISIPLINORE NDAJ DEPUTETIT TAULANT BALLA

Në mbështetje të nenit 11, pika 5 dhe 64 e 65, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Byroja e Kuvendit, në mbledhjen e datës 4.3.2011, pas verifikimit të fakteve se deputeti Taulant Balla në seancën plenare të datës 3.3.2011 ka shpifur, fyer dhe kërcënuar rëndë anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Kryetaren e Kuvendit si dhe ka provokuar rrëmujë në sallë, pas konstatimit të fakteve që ky deputet, edhe pas tërheqjes së vëmendjes disa herë nga Kryetarja e Kuvendit, dhënjes së verejtjes dhe më pas përjashtimit nga seanca plenare, nuk pranoi të zbatonte urdhërin, edhe pas ndërprerjes së seancës plenare, duke penguar zhvillimin e rregullt të seances plenare, me propozim të më shumë se 7 deputetëve,

V E N D O S I:

I. Deputeti Taulant Balla, për shpifje, fyerje dhe fjalë kërcënuese ndaj anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe Kryetares së Kuvendit si dhe për provokim rrëmuje, për vazhdimin e sjelljeve të mësipërme edhe pas tërheqjes së vëmendjes disa herë nga Kryetarja e Kuvendit, dhënjes së verejtjes dhe më pas përjashtimit nga seanca plenare, për refuzim për të zbatuar masën disiplinore të përjashtimit të tij nga seanca plenare edhe pas ndërprerjes së saj duke penguar zhvillimin e rregullt të seances plenare, përjashtohet nga pjesëmarrja në punimet e komisioneve të Kuvendit dhe seancës plenare për një periudhë 21 ditore.

II. Masat disiplinore shoqërohen me sanksionin financiar të ndalimit të pagës për 21 ditë duke filluar prej datës së marrjes së vendimit.

III. Ngarkohet Shërbimi i Sigurisë dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Arlon Bonushi

Lulzim Selçaj